

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE #4

# **Siguria e furnizimit me ujë në zonat rurale**

## **SQARIM**

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër”, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Let’s Do It Peja. Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

PËRMBLEDHJE E POLITIKËS #4

# **Siguria e Furnizimit me Ujë në Zonat Rurale**

**Prill, 2024**

# **PËRMBAJTJA**

<b>Shkurtesat</b> .....	5
<b>1. HYRJE</b> .....	6
<b>2. ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE</b> .....	7
<b>2.1 Korniza ligjore</b> .....	7
<b>2.2 Korniza institucionale</b> .....	8
<b>3. GJENDJA AKTUALE DHE SFIDAT</b> .....	11
<b>3.1 Siguria e furnizimit me ujë në zonat rurale që kanë sistem të furnizimit me ujë të cilat nuk menaxhohen nga kru-të</b> .....	12
<b>3.2 Siguria e ujit në zonat rurale ku furnizimi me ujë bëhet nga burimet individuale të ujit</b> .....	13
<b>3.3 Politikat dhe Strategjitë e Qeverisë</b> .....	14
<b>4. POLITIKA E REKOMANDUAR</b> .....	15
<b>Referencat</b> .....	17
<b>Shtojca 1</b> .....	18

## SHKURTESAT

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
ME	Ministria e Ekonomisë
NJPM NP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
SHUKOS	Shoqata e Ujësjetësve të Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ

# 1. HYRJE

Uji është qenësor për njerëzit dhe të gjitha gjallesat tjera në tokë. Sigurimi i qasjes në ujë të sigurt është një prej mjeteve më efektive në promovimin e shëndetit dhe reduktimin e varfërisë.

Duke pasur parasysh se qasja në ujë të pijshëm dhe sanitari janë të domosdoshme për jetesë të shëndetshme dhe dinjitet njerëzor, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) në vitin 2010 këto i ka përcaktuar si e drejtë e njeriut. Megjithatë, sipas të dhënave për vitin 2020, rreth 2 miliard njerëz në botë (26% e popullsisë botërore) nuk kanë qasje në ujë të sigurt<sup>1</sup>. Pra sipas të dhënave të OKB, rreth 74% e popullsisë në botë ka qasje në ujë të sigurt për pije, dhe me këtë trend të zhvillimit, deri në vitin 2030 qasja e popullsisë botërore në sisteme të ujësjellësit do të rritet në 81% që do të thotë se objektivi SDG 6 ('Sustainable Development Goal') për qasje universale në ujë të sigurt nuk do të arrihet, për arritje të këtij objektivi duhet të katërfishohet shkalla e progresit aktual.

Qasja e popullsisë së Kosovës në sisteme të furnizimit me ujë është relativisht e lartë<sup>2</sup>, 94.5%<sup>3</sup> e popullsisë kanë qasje në sisteme të ujësjellësit. Prej këtyre banorëve që kanë qasje në sisteme të ujësjellësit, 79% jetojnë në vendbanime ku sistemet e ujësjellësit menaxhohen nga Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të), ndërsa pjesa tjetër në vendbanime ku sistemet e ujësjellësit 'menaxhohen' nga komuniteti/banorët.

Zonat urbane janë të mbuluara plotësisht me sisteme të ujësjellësit, ndërsa sa i përket popullsisë rurale, **rreth 96,000<sup>4</sup> banorë jetojnë në vendbanime (300 fshatra) të cilat nuk kanë sisteme publike të ujësjellësit**. Në këto zona rurale ku nuk ka sistem të ujësjellësit furnizimi i popullsisë me ujë bëhet në shumicën e rasteve nga pusët individuale (në disa raste edhe nga burime natyrore të ujit).

Studimet dhe raportet e shumta të realizuara për sistemet rurale të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të (p.sh. Studimi i Mbulueshmërisë dhe Qëndrueshmërisë, CDI/SKAT, 2010) kanë konkluduar se edhe sistemet rurale të veçanta, të cilat janë funksionale, në përgjithësi operohen dhe mirëmbahen keq. Problem fundamental tek këto sisteme paraqet sidomos mungesa e plotë e monitorimit të cilësisë së ujit dhe rrjedhimisht rreziku që ky fakt paraqet për shëndetin e popullatës që furnizohet me ujë nga këto sisteme.

---

<sup>1</sup> Raporti i Kombeve të Bashkuara për Vitin 2023 për Zhvillimin e Ujërave në Botë: *Partneritetet dhe Bashkëpunimi për Ujë* - <file:///C:/TheUnitedNationsWorldWaterDevelopmentReport2023-Partnershipsandcooperationforwater.pdf>

<sup>2</sup> Bazuar në të dhënat e Kompanive Rajonale të Ujit.

<sup>3</sup> Kjo e dhënë nuk përfshin 4 komunat veriore të Republikës së Kosovës.

<sup>4</sup> Nuk përfshihen 4 komunat në veri të Republikës së Kosovës.

## 2. ASPEKTET LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

Struktura organizative dhe institucionale e sektorit të shërbimeve ujore (shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimit) është shumë mirë e rregulluar, madje konsiderohet si model edhe për vendet e rajonit nga forume e organizata të ndryshme ndërkombëtare për sektorin e ujërave, por edhe nga vet hisedarë dhe donatorë të sektorit nga shtetet fqinje. Organizimi i shërbimeve përmes Kompanive Rajonale të Ujit (KRU-ve) dhe rregullimi i këtyre shërbimeve përmes rregullatorit të pavarur, Autoritetit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (ARRU) konsiderohen kornizë e duhur institucionale e këtij sektori që ka mundur ngritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të këtij sektori gjatë viteve. Përmirësimi i performancës së këtij sektori është konfirmuar dhe vlerësuar edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare<sup>5</sup> në të cilat qëndrueshmëria e sektorit të shërbimeve të ujit të Kosovës vlerësohet dukshëm më i avancuar se sa i të gjitha vendeve të rajonit.

### 2.1 Korniza ligjore

Aktet më të rëndësishme ligjore për rregullimin e shërbimeve ujore janë si vijon:

(i) [Ligji nr. 05/l - 042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit me plotësimet dhe ndryshimet e tij të bëra me Ligjin Nr. 06/L-088](#)

Me këtë ligj është themeluar Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU) si rregullator i pavarur ekonomik për shërbimet e furnizimit publik me ujë dhe shërbimet e kanalizimit, si dhe janë rregulluar të gjitha aspektet e rregullimit të shërbimeve të ujit, si: licencimi i kompanive që ofrojnë këto shërbime, përcaktimi i tarifave të shërbimit që duhet të zbatohen nga këto kompani, standardet e shërbimit që duhet të përmbushen nga kompanitë që ofrojnë shërbimet (KRU-të), të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të konsumatorëve dhe kompanive të ujit, etj.

Në bazë të këtij ligji, ARRU ka nxjerrë një numër të akteve nënligjore–rregulloreve:

- [Rregullore Nr. 04/2016 për Inspektimin e Përmbushjes së Obligimeve Rregullore nga Ofruesit e Licencuar të Shërbimeve të Ujit në Kosovë](#)
- [Rregullore Nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë](#)
- [Rregullore Nr.06/2016 për Ndërprerje nga Shërbimet e Ujit në Kosovë](#)
- [Rregullore nr. 09/2019 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve](#)
- [Rregullore Nr.10/2019 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë](#)
- [Rregullore Nr.12/2020 për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujit në Kosovë](#)

---

<sup>5</sup> Water and Wastewater Services in Danube Region: A State of the Sector – 2018. June 2019 - <https://sos2018.danubis.org/eng/report/country-pages/>

- [Rregullore Nr.13/2021 për Kartën e Konsumatorit dhe Rregullimin e Marrëdhënieve Juridike në mes të Konsumatorit dhe Ofruesit të Shërbimeve të Ujit](#)

(ii) [Ligji Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike](#) me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në vitin 2011 me [Ligjin Nr. 04/L111](#) dhe në vitin 2015 me [Ligjin Nr. 05/L009](#)

Vendos kornizën ligjore për pronësinë e ndërmarrjeve publike (NP) dhe qeverisjen e tyre korporative në pajtim me praktikat e njohura ndërkombëtarisht, dhe si i tillë ka për synim krijimin e modaliteteve efektive të raportimit dhe llogaridhënies për mbikëqyrjen e NP-ve. Ligji përcakton se NP-të (përfshirë edhe KRU-të) janë të organizuara si Shoqëri Aksionare. KRU-të e klasifikuara si NP qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës dhe të drejtat pronësore ushtrohen nga Qeveria e Kosovës. Qeveria i përgjigjet dhe i jep llogari Kuvendit lidhur me arritjen e objektivave lidhur me KRU-të.

Njësia për Politika dhe Monitorim (NJPM) të NP-ve e Ministrisë së Ekonomisë (ME) është njësi e themeluar me këtë ligj që e mbështet Qeverinë dhe ME në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre lidhur me NP-të. NJPM është e obliguar që në baza vjetore të vlerësojë performancën e drejtorëve të bordeve të secilës NP

(iii) [Ligji Nr. 02/L-078 për Shëndetësi Publike](#) i plotësuar me [Ligjin Nr. 08/1-048](#)

Ligji për Shëndetësinë Publike përkufizon, përpos tjerash, institucionet përgjegjëse për implementimin e politikave shëndetësore si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) për monitorimin e kualitetit të ujit të pijes.

Në bazë të këtij ligji, Qeveria e ka miratuar, në vitin 2021, [Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor](#), me të cilin janë përcaktuar standardet e cilësisë së ujit të pijshëm, monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

(iv) [Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës](#)

Ligji për ujërat e Kosovë në paragrafin e parë të nenit të parë thekson që “*Resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj.*” Kjo vie në theks sidomos në rastet kur komunitetet kundërshtojnë integrimin e sistemeve rurale vetanake me pretekst se uji është i “tyre” apo në rastet kur një fshat kundërshton ndarjen e resurseve brenda territorit të tyre me fshatin fqinj, pra duke pretenduar gabimisht që uji është i ‘tyre’.

## 2.2 Korniza institucionale

### Qeveria e Kosovës – Këshilli Ndërmintor për Ujëra (KNU)

Me qëllim të ushtrimit efektiv të përgjegjësisë të veta në sektorin e ujit, në vitin 2013, me Ligjin për Ujërat e Kosovës është themeluar Këshilli Ndërmintor për Ujëra (KNU) si



organ vendimmarrës dhe mbikëqyrës i sektorit të ujërave si tërësi, i cili udhëhiqet nga Kryeministri dhe përbëhet nga katër ministra të linjës, aktualisht, nga Ministrat e: (i) MMPHI (për resurse ujore), (ii) ME (për shërbime ujore), (iii) MF (financa dhe buxhet) dhe (iv) MBPZHR (për ujitje). Në KNU merr pjesë edhe komuniteti i donatorëve në sektorin e ujërave, por pa të drejtë vote. KNU koordinon dhe mbështet institucionet përkatëse në menaxhimin e ujërave në procesin e vendimmarrjes dhe propozimin e masave për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve ujore.

### **Ministria e Ekonomisë (ME)**

ME është Ministri trashëguese e ish-Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) që në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike i monitoron NP, përfshirë KRU-të dhe kompanitë e ujitjes. Ky monitorim bëhet përmes NJPM dhe qëllimi i tij është që të sigurohet transparenca dhe llogaridhënia në operimin e NP. Ky ligj definon kornizën ligjore që rregullon ushtrimin e të drejtave pronësore ndaj NP dhe rregullon parimet e qeverisjes korporative.

### **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)**

MMPHI është themeluar në vitin 2002 si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Infrastruktura i është shtuar në vitin 2021) dhe është përgjegjëse për planifikimin e mjedisit përfshirë resurset ujore, mbeturinat, kualitetin e ajrit, menaxhimin e tokës, dhe planifikimin hapësinor. Kjo Ministri është po ashtu përgjegjëse për planifikim afatgjatë të resurseve ujore dhe për zhvillimin e strategjisë ujore të vendit.

### **Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKSHPK)**

IKSHPK është institucion i Qeverisë nën kontrollin e Ministrisë së Shëndetësisë që ka përgjegjësi çështjet e shëndetit publik në Kosovë. Ai përcakton, monitoron dhe zbaton standardet e ujit të pijshëm në pajtim me *Ligjin për Shëndetësinë Publike* (Ligji Nr. Nr. 02/L-78) dhe *UA Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit për Konsum Njerëzor*.

### **Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU)**

ARRU është rregullator i pavarur i shërbimeve të ujit përgjegjës për sigurimin e jodiskriminimit dhe ofrimin e shërbimeve cilësore, efikente, dhe të besueshme me çmime të drejta dhe të arsyeshme për konsumatorët duke respektuar mjedisin dhe shëndetin publik. ARRU i jep llogari Kuvendit të Kosovës që emëron drejtorin dhe zëvendësin e tij. ARRU jep licenca të shërbimit NP-ve që ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë, kanalizim, dhe ujë me shumicë; i përcakton tarifatat për këto shërbime dhe nxjerrë aktet nënligjore për licencimin, tarifatat, standardet e shërbimit, ndërprerjet e ujit.

### **Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU-të)**

Të shtatë KRU-te iu ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizim pjesës më të madhe të popullatës. Ato janë nën pronësi publike të kontrolluara nga Qeveria e Kosovës përmes ME. KRU-të janë shoqëri aksionare dhe janë të licencuara nga ARRU. Ato kanë marrëveshje të shërbimit me komunat ku ofrojnë shërbimet e veta e të cilat përshkruajnë

detyrat dhe përgjegjësitë e secilës prej palëve. KRU-të udhëhiqen nga Bordet e Drejtorëve të cilat emërohen nga Qeveria.

### **Komunat**

Përgjegjësia për ofrimin e shërbimeve të ujit qëndron tek komunat ([Ligji për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë, Nr. 03/L-040](#)). Ato e ushtrojnë këtë përgjegjësi përmes KRU-ve në bazë të marrëveshjeve të shërbimit të cilat përcaktojnë të drejtat dhe obligimet reciproke.

### **Shoqata e Ujësjellësve dhe Kanalizimeve të Kosovës (SHUKOS)**

SHUKOS është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2001 për të përfaqësuar interesat e ofruesve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimit në Kosovë. Ajo ofron forum për shkëmbimin e informatave, përfaqëson interesat e KRU-ve dhe artikulon brengat e tyre. Po ashtu, ka mandat që të përforcojë kapacitetet e tyre dhe të ndërtojë politika të përbashkëta.

### 3. GJENDJA AKTUALE DHE SFIDAT

Me Agjendën 2030 të miratuar nga OKB në vitin 2015, janë përcaktuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm prej të cilave dy caqe të objektivit 6 kanë të bëjnë me qasjen në ujë të pijshëm dhe sanitari:

- 6.1 - *Deri më 2030, të arrihet qasje universale dhe e barabartë në ujë të pijshëm që është i sigurt dhe i përballueshëm;*
- 6.2 - *Deri më 2030, të arrihet qasje në sanitari adekuate dhe higjienë pa diskriminim për të gjithë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe atyre në situata të cenueshme.*

Këto objektiva janë miratuar edhe nga institucionet e Kosovës dhe për rrjedhojë Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar për veprim të përshejtuar për të përmbushur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky zotim është përfshirë me *Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2030 (SKZH)* dhe *Planin Kombëtar të Zhvillimit*, të miratuar në mars 2023, që përshkruan vizionin e Qeverisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe realizim të Agjendës 2030.


Sa i përket qasjes së popullatës në sistemet publike të ujësjellësit, ajo vlerësohet të jetë rreth 95%. Kjo duke pasur parasysh se sipas ARRU përqindja e popullatës që merr shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm nga sistemet që menaxhohen prej KRU-ve është 79%. Kur kësaj i shtohen edhe 87 sistemet funksionale të ujësjellësit të cilat sipas ARRU do të duhej të merren nën menaxhim gjatë vitit 2023, kjo përqindje do të **rritet në 84%**.<sup>6</sup>

Këto të dhëna përputhen me të dhënat e KRU-ve (shih shtojcën 1), sipas të cilave 79% e popullatës që jetojnë në 680 vendbanime furnizohen me ujë nga sistemet e ujësjellësit që menaxhohen nga KRU-të. Përpos këtyre, janë edhe 279 vendbanime rurale me 275 mijë banorë (15.5% e popullsisë së Kosovës) të cilat kanë sisteme të ujësjellësit por të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të.


Pra, sipas kësaj rezulton që 94.5% e popullsisë së Kosovës (1.65 milion nga 1.74 milion) kanë qasje në sisteme të ujësjellësit. Popullsia e mbetur prej rreth 96 mijë banorëve që jeton në 300 vendbanime rurale nuk kanë qasje në sisteme të ujësjellësit. Këto janë në të shumtën e rasteve vendbanime me numër të vogël të banorëve (ose fshatra pa asnjë banorë, si p.sh. Devetak dhe Dugë në komunën e Shtimjes; Reçicë, Përpellac, Muhazob në komunë e Podujevës; Dobrasellë në komunën e Obliq; Lipovicë, Shisharekë në komunën e Lipjanit etj.).

Të dhënat e mësipërme nuk përfshijnë 4 komunat në veri të vendit.

<sup>6</sup> Raporti i ARRU: Niveli i Shërbimeve të Ofruara nga Ofruesit e Licencuar 2023 - <https://www.arru-rks.org/assets/Inspektimi/Raportet/RaportiperNivelineSherbimeve2022.pdf>



Legjenda:

			
Vendbanime me qasje në sisteme të ujësjellësit – 89.6%	Vendbanime në proces ndërtimi i sistemeve të ujësjellësit – 4.9%	Vendbanime pa qasje në sistemin e ujësjellësit – 5.5%	Kufijtë e zonave të shërbimit të KRU-ve

**Figura: Mbulueshmëria me sisteme të furnizimit me ujë në Kosovë**

### **3.1 Siguria e furnizimit me ujë në zonat rurale që kanë sistem të furnizimit me ujë të cilat nuk menaxhohen nga kru-të**

Siç u tha më sipër, 279 vendbanime me rreth 275 mijë banorë kanë sisteme të ujësjellësit të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të.

Uji që furnizohet përmes këtyre sistemeve *nuk kontrollohet nga furnizuesi i ujit* (meqenëse nuk ka një furnizues të ujit të licencuar siç është rasti me KRU-të), dhe *nuk mbikëqyret nga IKSHP*. Për pasojë, nuk ka informacion për cilësinë e ujit që furnizohet nga këto sisteme. Gjithashtu, burimet e ujit nga të cilat furnizohen këto sisteme nuk i kanë të përcaktuara zonat e mbrojtura të burimeve të ujit dhe, rrjedhimisht, *nuk zbatohen kurrfarë masa të mbrojtjes së këtyre burimeve* që do të duhej të zbatoheshin bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e burimeve të ujit.

Komuniteti i këtyre fshatrave nuk ka kurrfarë marrëveshje formale as me komunën e as me KRU-në përkatëse për ofrimin e mbështetjes teknike, pagesën e shërbimeve të ujit, investimet, etj. Zakonisht, komuniteti e cakton një banorë të fshatit i cili k.a njohuri elementare teknike dhe ai person ka përgjegjësi për funksionimin e sistemit (mirëmbajtjen dhe arkëtimin e pagesave). I njëjti nuk ka ndonjë status formal që do ta adresonte përgjegjësinë dhe llogaridhënien në rast të keqmenaxhimit të resurseve ujore, paqëndrueshmërisë së investimeve, cilësisë së ulët të shërbimeve, etj.

Bazuar në këto që u thanë më sipër, mund të konkludohet se siguria e ujit që furnizohet nga sistemet e ujësjellësit të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të *nuk është në nivelin e duhur* meqenëse nuk i nënshtrohet kurrfarë kontrolli dhe mbikëqyrjeje nga institucionet përgjegjëse si dhe nuk zbatohen masa mbrojtëse për burimet e ujit nga të cilat furnizohen këto sisteme. Për më tepër, duke pasur parasysh se nuk ka mirëmbajtje të rregullt dhe preventive të këtyre sistemeve si dhe faktin se nuk ka incentivë për kursim të ujit pasi që uji nuk paguhet bazuar në sasinë e konsumuar, furnizimi me ujë i këtyre vendbanimeve nuk është i rregullt dhe shpeshherë ka ndërprerje.

### **3.2 Siguria e ujit në zonat rurale ku furnizimi me ujë bëhet nga burimet individuale të ujit**

Pjesa e popullsisë (rreth 5%) që furnizohet nga sistemet individuale të ujësjellësit (puse, burime natyrore) është më e cenueshja sa i përket sigurisë së ujit.

Kjo sepse:

- a) puset nga furnizohet kjo kategori e popullsisë zakonisht janë të ndërtuara *pa respektuar standardet* sa i përket mbrojtjes dhe sigurimit nga ndotjet potenciale;
- b) uji që furnizohet nga sistemet individuale të ujësjellësit zakonisht *nuk i nënshtrohet kontrollit* nga institucionet përkatëse, përpos kontrollit të rrallë që mund të bëhet me iniciativë të shfrytëzuesit të pusit.

Si rrjedhojë, rreziku nga ndotja e ujit të pijshëm në këto raste është pothuajse permanent dhe siguria e ujit që furnizohet përmes burimeve individuale të ujësjellësit është minimale.

### 3.3 Politikat dhe Strategjitë e Qeverisë

#### Politika e Qeverisë për Ujëra

Me dokumentin e politikës së ujërave që është miratuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2015, është përcaktuar si Politikë e Qeverisë integrimi i sistemeve rurale të ujësjellësit nën menaxhim të KRU-ve. Kjo politikë është adoptuar duke pasur për synim sigurimin e menaxhimit të duhur dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimit në zonat rurale. Njëkohësisht, sipas këtij dokumenti të politikës së ujërave, të gjitha sistemet e reja të ujësjellësit do të planifikohen dhe implementohen nga KRU-të.

#### Strategjia Shtetërore për Ujëra

Me *Rishikimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027*<sup>7</sup>, të miratuar nga Qeveria e Kosovës në qershor të vitit 2023, si një prej objektivave<sup>8</sup> të Qeverisë është përcaktuar edhe: *“Integrimi nën menaxhim të KRU-ve i sistemeve rurale të pintegruara vlerësohet të jetë zgjidhje që siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të këtyre sistemeve. Vetëm në këtë mënyrë mundësohet operim dhe mirëmbajtje adekuate e këtyre sistemeve, investime sistematike në rehabilitim dhe përtëritje të aseteve, monitorim i cilësisë së ujit etj.*

Me këtë objektiv të Strategjisë synohet që popullsia që aktualisht furnizohet me ujë nga sistemet rurale të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të shumica e tyre të integrohen në KRU, dhe kështu **nga 13% sa janë aktualisht dhe të zvogëlohet në 3% deri në vitin 2027.**

---

<sup>7</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78647>

<sup>8</sup> Objektiv i specifik 4.2: Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat rurale

## 4. POLITIKA E REKOMANDUAR

Problemi i sigurisë së ujit të pijshëm në zonat rurale adresohet në mënyrë të duhur dhe efektive përmes:

- 1) Integritet të sistemeve ekzistuese të ujësjellësit nën menaxhim të KRU-ve, dhe
- 2) Ndërtimit të sistemeve të ujësjellësit në zonat rurale ku ato mungojnë.

Duke pasur parasysh që shtatë KRU-të janë ndërmarrje publike të licencuara nga ARRU që kanë kapacitet profesionale dhe financiare për menaxhimin e duhur të sistemeve të ujësjellësit, përfshirë edhe kontrollimin e cilësisë së ujit dhe ofrimin e sigurisë së ujit të pijshëm, është me rëndësi jetike që të gjithë sistemet rurale të cilat aktualisht nuk menaxhohen nga KRU-të, të futen nën menaxhimin e tyre.

Në këtë mënyrë do të sigurohet:

- a) **Cilësia e duhur e ujit të pijes që i ofrohet popullatës e cila furnizohet përmes këtyre sistemeve.** – Kjo është me rëndësi esenciale për jetën dhe mbrojtjen e shëndetit publik të popullatës së këtyre fshatrave dhe duhet të sigurohet përmes përkufizimit të saktë dhe krijimit të zonave mbrojtëse të burimeve si dhe përmes trajtimit (pastrimit) adekuat të ujit që distribuohet në sistem.
- b) **Monitorim i rregullt i cilësisë së ujit që furnizohet përmes këtyre sistemeve.** – Ky monitorim do të duhej të kryhej në mënyrë sistematike në pajtim me ligjet dhe standardet në fuqi që zbatohen nga institucioni kompetent që është Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Kështu mundësohet detektimi me kohë i problemeve eventuale që mund të afektojnë cilësinë e ujit dhe ndërmarrja e masave adekuate për evitimin e efekteve të dëmshme për jetën dhe shëndetin e popullatës.
- c) **Zbatimi i standardeve të shërbimit për konsumatorët në përputhje me kornizën ligjore që zbatohet nga ARRU.** – Me kornizën ligjore janë përcaktuar standardet minimale teknike, komerciale, dhe të shërbimeve ndaj konsumatorit që duhet t'i plotësojë një ofrues publik i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit. Përbushja e këtyre standardeve është me rëndësi për cilësinë e shërbimit dhe rrjedhimisht për mirëqenien e popullatës që furnizohet me ujë nga këto sisteme.
- d) **Menaxhim i duhur i kërkesës për ujë me mekanizma adekuat duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit.** – Zbatimi i mekanizmave që influencojnë shfrytëzimin racional të ujit të pijes ndikon në: (i) cilësinë e furnizimit me ujë, dhe (ii) shfrytëzim optimal të resurseve ujore. Mekanizmat si: matja e ujit të distribuuar në sistem, instalimi i ujëmatësve individual të konsumatorëve, aplikimi i tarifave adekuate për faturimin e ujit të konsumuar etj. konsiderohen të jenë efikase për menaxhimin e kërkesës për ujë.
- e) **Qëndrueshmëri e sistemeve rurale të ujësjellësit.** – Sigurimi i qëndrueshmërisë së funksionimit të sistemeve dhe cilësisë së shërbimit që ofrohet përmes tyre është qenësor për shëndetin, ekonominë dhe mirëqenien e popullatës së këtyre fshatrave. Kështu mundësohet struktura institucionale

për: (i) mirëmbajtje preventive të të gjitha komponentëve të sistemit, (ii) rehabilitim dhe zhvillim sistematik të të gjitha pjesëve përbërëse të sistemit (burimeve, rezervuarëve, pompave, rrjetit shpërndarës, valvuleve dhe ujëmatësve) në pajtim me standardet teknike dhe praktikën e mira.

Për zbatimin e kësaj politike, rekomandohet që Qeveria e Kosovës të ndërmerr veprimet si vijon:

- 1) **Të kërkojë nga KRU-të hartimin e planeve për integrimin e sistemeve rurale të ujësjellësit dhe kanalizimit** si dhe zgjerimin e shërbimeve në zonat rurale ku nuk ka sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- 2) **Të ofrojë mbështetje financiare për KRU-të për zbatimin e planit** me qëllim të rehabilitimit të sistemeve ekzistuese të ujësjellësit para se ato të integrohen si dhe për ndërtimin e sistemeve në zonat rurale ku mungojnë ato.
- 3) **Të sigurojë që financimi i shërbimeve ujore në fshatra të bëhet përmes KRU-ve** dhe/ose Ministrisë së Ekonomisë si ministri përgjegjës për shërbime të ujit dhe të evitohet ndarjen e buxhetit për ujësjellës e kanalizime përmes MMPHI dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, që bie ndesh edhe me ligjin edhe me përgjegjësitë institucionale dhe kapacitetet e këtyre ministrive.
- 4) **Në rastet kur komunat financojnë sistemet rurale të ujësjellësit**, të kërkohej përfshirja e KRU-ve gjatë gjithë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të projektit.
- 5) **Të mbështes integrimin e sistemeve rurale të ujësjellësit dhe kanalizimit në KRU**, në rastet kur komuniteti i fshatit refuzon integrimin, përmes veprimeve të nevojshme ligjore, administrative dhe politike. Këto veprime të ndërmerren edhe për rastet kur komuniteti kundërshton ndarjen e resurseve ujore brenda territorit të tyre me fshatin fqinj.
- 6) **T'i përmbahet planit të veprimit të Strategjisë së Rishikuar të Ujërave 2023-2027** dhe të reflektojë kostot për plotësimin e këtij obligimi në buxhetin e ME si dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
- 7) **Ministria e Ekonomisë të themelojë departamentin për shërbime të ujit** dhe të sigurojë planifikimin, zbatimin dhe qëndrueshmërinë e investimeve të shërbimeve ujore.



## Referencat

- 1) Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit. *Niveli i Shërbimeve të Ofruara nga Ofruesit e Licencuar 2023* - [https://www.arru-rks.org/Raporti\\_për\\_Nivelin\\_e\\_Sherbimeve2022\(1\).pdf](https://www.arru-rks.org/Raporti_për_Nivelin_e_Sherbimeve2022(1).pdf);
- 2) Danube Water Program (2019). *Water and Wastewater Services in Danube Region: A State of the Sector – 2018*. June 2019; [https://sos2018.danubis.org/files/File/SoS\\_Report-2018.pdf](https://sos2018.danubis.org/files/File/SoS_Report-2018.pdf);
- 3) Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (2018). *Raporti-vjetor-Cilësia-e-ujit-të-pijshëm-në-Kosovë-2017.pdf (niph-rks.org)*, qershor 2017;
- 4) Qeveria e Kosovës (2023). *Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 dhe Plani i Veprimit 2023-2025*, Prishtinë - [https://mmphi.rks.gov.net/MMPHIFolder/2023\\_0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf](https://mmphi.rks.gov.net/MMPHIFolder/2023_0cdc-4825-964b-b42d6466fd9e.pdf);
- 5) United Nations, *The United Nations World Water Development Report 2023: Partnerships and Cooperation for Water*. UNESCO, Paris - [file:///C:/The\\_United\\_Nations\\_World\\_Water\\_Development\\_Report\\_2023-Partnerships\\_and\\_cooperation\\_for\\_water.pdf](file:///C:/The_United_Nations_World_Water_Development_Report_2023-Partnerships_and_cooperation_for_water.pdf).

## SHTOJCA 1:

### Mbulueshmëria e vendbanimeve me sisteme të ujësjellësit dhe shkalla integritit të sistemeve rurale në KRU

Vendbanime	Banorë	Komuna	Integruar ne KRU			Paintegruar			Total		
			nr i vendb.	popullata	%	nr i vendb.	popullata	%	nr i vendb.	popullata	%
37	40,019	Deçani	34	38,203	95.5	3	1,816	4.5	37	40,019	100.0
54	38,496	Klina	29	24,730	64.2	18	10,865	28.2	47	35,595	92.5
79	96,450	Peja	45	86,309	89.5	14	9,361	9.7	59	95,670	99.2
50	39,289	Istogu	47	37,178	94.6	3	1,486	3.8	50	38,664	98.4
3	6,084	Juniku	3	6,084	100.0	0	-	0	3	6,084	100.0
<b>223</b>	<b>220,338</b>	<b>HIDRODRINI</b>	<b>158</b>	<b>192,504</b>	<b>87.4</b>	<b>38</b>	<b>23,528</b>	<b>10.7</b>	<b>196</b>	<b>216,032</b>	<b>98.0</b>
88	99,610	Gjakova	83	98,500	98.9	2	1,028	1.0	85	99,528	99.9
36	59,213	Rahoveci	32	58,275	98.4	2	823	1.4	34	59,098	99.8
10	16,535	Prizreni	10	16,535	100.0	0	-	-	10	16,535	100.0
<b>134</b>	<b>175,358</b>	<b>GJAKOVA</b>	<b>125</b>	<b>173,310</b>	<b>98.8</b>	<b>4</b>	<b>1,851</b>	<b>1.1</b>	<b>129</b>	<b>175,161</b>	<b>99.9</b>
66	162,085	Prizreni	35	130,142	80.3	22	25,875	16.0	57	156,017	96.3
41	59,772	Suhareka	20	42,955	71.9	7	8,272	13.8	27	51,227	85.7
36	33,997	Dragash	4	5,157	15.2	32	28,840	84.8	36	33,997	100
44	54,613	Malisheva	19	30,271	55.4	17	18,243	33.4	36	48,514	88.8
1	5,507	Mamusha	1	5,507	100	0	-	0	1	5,507	100
<b>188</b>	<b>315,974</b>	<b>HIDROREGJIONI</b>	<b>79</b>	<b>214,032</b>	<b>67.7</b>	<b>78</b>	<b>81,230</b>	<b>25.7</b>	<b>157</b>	<b>295,262</b>	<b>93.4</b>
45	108,610	Ferizaj	40	103,735	95.5	0	-	0	40	103,735	95.5
11	9,403	Hani i Elezit	2	4,785	50.9	2	1,277	13.6	4	6,062	64.5
15	6,949	Shtërpçë	0	-	0.0	13	6,737	96.9	13	6,737	96.9
31	33,409	Kacanik	8	19,820	59.3	15	11,039	33.0	24	30,859	92.4
<b>102</b>	<b>158,371</b>	<b>BIFURKACIONI</b>	<b>50</b>	<b>128,340</b>	<b>81.0</b>	<b>30</b>	<b>19,053</b>	<b>12.0</b>	<b>81</b>	<b>147,393</b>	<b>93.1</b>
49	90,178	Gjilan	15	73,781	81.8	11	12,706	14.1	26	86,487	89.0
39	46,879	Viti	7	12,696	27.1	19	27,905	59.5	26	40,601	86.6
58	36,085	Kamenicë	8	18,459	51.2	12	9,861	27.3	20	28,320	78.5
26	6,729	Novobërdë	7	3,539	52.6	3	1,116	16.6	10	4,655	69.2
4	2,556	Kllokot	0	-	0.0	3	2,316	90.6103	3	2,316	90.6
13	3,866	Ranillug	8	2,881	74.5	3	829	21.4	11	3,710	96.0
3	1,787	Partesh	1	974	54.5	0	-	0	2	974	54.5
<b>192</b>	<b>182,427</b>	<b>HIDROMORAVA</b>	<b>37</b>	<b>112,330</b>	<b>61.6</b>	<b>48</b>	<b>53,904</b>	<b>29.5</b>	<b>85</b>	<b>167,063</b>	<b>91.6</b>
47	71,909	Mitrovicë	26	66,828	92.9	3	1,168	1.6	3	67,996	94.6
65	68,582	Vushtri	33	56,682	82.6	19	10,310	15.0	52	66,992	82.3
49	50,855	Skenderaj	23	29,422	57.9	22	19,526	38.4	45	48,948	96.3
<b>161</b>	<b>191,346</b>	<b>MITROVICA</b>	<b>82</b>	<b>152,932</b>	<b>79.9</b>	<b>44</b>	<b>31,004</b>	<b>16.2</b>	<b>100</b>	<b>183,936</b>	<b>96.1</b>
43	198,897	Prishtina	23	192,603	96.8	0	-	0	23	192,603	96.8
77	88,499	Podujeva	34	62,553	70.7	5	8,281	9.4	39	70,834	80.0
20	21,549	Obiliqi	16	20,814	96.6	2	733	3.4	18	21,547	100
16	34,827	F. Kosova	15	33,891	97.3	1	936	2.7	16	34,827	100.0
62	57,605	Lipjani	23	33,562	58.3	20	18,863	32.7	43	52,425	91.0
35	58,531	Glllogoc	10	24,198	41.3	20	27,256	46.6	30	51,454	87.9
23	27,324	Shtime	15	24,247	88.7	3	2,518	9.2	18	26,765	98.0
17	10,675	Graçanica	13	9,679	90.7	4	996	9.3	17	10,675	100.0
<b>293</b>	<b>497,907</b>	<b>PRISHTINA</b>	<b>149</b>	<b>401,547</b>	<b>80.6</b>	<b>55</b>	<b>59,583</b>	<b>12.0</b>	<b>204</b>	<b>461,130</b>	<b>92.6</b>
<b>1293</b>	<b>1,741,721</b>		<b>680</b>	<b>1,374,995</b>	<b>78.9</b>	<b>297</b>	<b>270,153</b>	<b>15.5</b>	<b>977</b>	<b>1,645,977</b>	<b>94.5</b>





**Funded by  
the European Union**

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Let’s Do It Peja.

Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

**Let’s Do It Peja**

Adresa: Shtëpia e Kulturës, kati III

30000, Pejë, Kosovë

Email: [letsdoitpeja@gmail.com](mailto:letsdoitpeja@gmail.com)

Tel: +383 49 124 548

[www.puacw.ldip.com](http://www.puacw.ldip.com)



Promoting Universal  
Access to **Clean Water**